



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.03.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për veprimtarinë e këtij shërbimi gjatë vitit 2018.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Elona Hoxha, Pjerin Ndreu, Paulin Sterkaj, Antoneta Dhima, Spartak Braho dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Ylli Shehu, Myslim Murrizi dhe Elena Xhina.

Të ftuar:

Arlind Gjokutaj - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave

Artan Shiqerukaj - Drejtor i Drejtorisë Juridike, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Trajnimeve

Agim Muslia - Drejtor i Drejtorisë së Përputhshmërisë dhe TI.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni kemi parashikuar një seancë dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për veprimtarinë e këtij institucioni gjatë vitit 2018.

Sikundër ju njoftuam dje, në seancën dëgjimore me Shërbimin Informativ Shtetëror, Komisioni i Sigurisë ka planifikuar që brenda muajit mars të zhvillojë seanca dëgjimore me një pjesë të institucioneve të sigurisë, të cilat, sipas ligjit organik të tyre, kanë detyrimin të bëjnë raportimin vjetor, periodik, pranë këtij komisioni.

Të ftuar për të paraqitur raportin e punës së këtij institucioni kemi drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, zotin Arlind Gjokutaj, drejtorin e Drejtorisë Juridike, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Trajnimeve, zotin Artan Shiqerukaj, dhe drejtorin e Drejtorisë së Përputhshmërisë, zotin Agim Muslia.

Para se të fillojmë me procedurën normale, dua të bëj me dije se raporti që paraqet ky institucion nuk është një raport konfidencial, ndaj një kopje të këtij raporti e ka secili anëtar i këtij komisioni. Gjithashtu, dua t'ju siguroj se në Komisionin e Sigurisë asnjë mbledhje ose asnjë dëgjese, e cila duhet të zhvillohet me dyer të mbyllura, nuk është zhvilluar në shkelje të rregullave.

E bëj këtë sqarim për faktin se ishte tërësisht e pavend dhe tërësisht e papëlqyeshme që dje këtu kishte medie prezent. Kështu që medieve dhe të tjerëve, që ishin prezent në mbledhje, iu sqarua se kushdo që nuk kishte një certifikatë sigurie, natyrisht nuk do të ishte në mbledhje. Dje deputetët, të cilët ende nuk janë pajisur me këtë dokument, kanë qenë për çeljen e mbledhjes, por jo për të dëgjuar raportin, ashtu siç ishin prezent edhe gazetarët. Kjo bëhet edhe për transparencën e kuorumit dhe të rregullave që lejojnë hapjen e një mbledhjeje dhe kryerjen e saj. Kështu që sot mbledhja dhe raportimi është i hapur për të gjithë.

Fjala është për zotin Gjokutaj.

Faleminderit!

Arlind Gjokutaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Duke ju falënderuar për ftesën, në radhë të parë, më lejoni të shpreh vlerësimin tim për veprimtarinë e Komisionit të Sigurisë Kombëtare për bashkëpunimin që kemi pasur ndër vite, në veçanti për mbështetjen e dhënë për institucionin tonë.

Në bazë të detyrimit tonë për të raportuar përpara këtij komisioni po ju informoj si në vijim:

Viti 2018 ka qenë shumë intensiv për institucionin tonë për shkak të angazhimit në shumë procese të rëndësishme, nga të cilat më të rëndësishmet theksoj: vlerësimin e komitetit Moneyval të Këshillit të Europës; përfshirjen dhe kontributin e dhënë në disa task-forca dhe plane veprimi; rritjen e volumit të analizës së rasteve të dyshimta dhe veprimtari të tjera; detyrë që jemi përpjekur ta kryejmë me korrektësi dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa cenuar cilësinë e informacionit të analizuar e shpërndarë si me agjencitë ligjzbatuese brenda vendit, ashtu edhe me homologët dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Së bashku me raportimin ju kemi dërguar edhe një aneks, ku përfshihen statistikatat kryesore të punës sonë, por që ka vend edhe për më tepër detajime, të cilat do të mundohem t'i prek gjatë fjalës sime. Gjithsesi, mund të ma ndërprisni fjalën nëse do të keni ndonjë paqartësi ose në fund mund t'i mbledhim të gjitha pyetjet.

Sipas fushës së veprimtarisë, unë do të doja ta nisja nga procesi i vlerësimit të Shqipërisë nga komiteti Moneyval, i cili është një proces shumë i rëndësishëm, që u finalizua vitin e fundit.

Komiteti Moneyval është Komiteti i Këshillit të Europës, që kryen vlerësimin e vendeve anëtare për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, përshtatshmërisë ligjore dhe efektivitetit. DPPP-jë ka pasur një rol koordinues e udhëheqës në këtë proces, i cili përfshinte angazhimin e një sërë institucioneve publike dhe të pavarura, por edhe angazhimin e sektorit privat. Ky ka qenë një proces i gjatë, i cili ka zgjatur rreth dy vjet dhe raporti u finalizua vitin e fundit. Siç e thashë në fillim, procesi synonte vlerësimin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor në vend për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me ato që njihen si 40 rekomandimet e *Financial Action Task Force*. Këto rekomandime njihen dhe janë të pranueshme si standardi detyrues dhe unifikues në rang botëror për këto çështje, pra për pastrimin e parave dhe për financimin e terrorizmit.

Risia e këtij raundi ishte edhe vlerësimi paralel i efektivitetit të sistemit në parandalimin dhe në luftën ndaj këtyre fenomeneve. Periudha e vlerësimit ishte relativisht e gjatë, fillonte nga viti 2011 deri në vitin 2017. Ky rang tregoi se vlerësimi për pjesën teknike, pra për përputhjen e

legjislacionit, ka marrë një rezultat relativisht të mirë, ku nga 40, rezultojnë vetëm 10 rekomandime të përmbushura pjesërisht dhe vetëm një i papërmbushur. Ky ishte një rezultat më i mirë se rezultati i vlerësimit të mëparshëm të kryer në vitin 2010, kur kishte rreth 30 rekomandime të përmbushura pjesërisht. Ky raund vlerësimi tregoi se vërehen disa mangësi në pjesën e efektivitetit, veçanërisht në numrin e ulët të dënimeve nga gjykatat për pastrim parash, mangësi në hetimin e financimit të terrorizmit dhe një boshllëk ligjor në lidhje me zbatimin e sanksioneve për financuesit e armëve të shkatërrimit në masë. Ndërkohë, raporti tregon dhe vlerëson me efektivitet të ndjeshëm sistemin parandalues në vend, pra përmbushjen e detyrimeve nga subjektet ligjore, si: bankat, noterët, shoqëritë e transfertave. Gjithashtu vlerësohet me efektivitet të lartë edhe puna e njësisë së inteligjencës financiare, që është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

Për sa i përket pjesës së efektivitetit, pra masave parandaluese, duhet theksuar se ne jemi vendi i dytë në botë, nga mbi 50 vende të vlerësuara deri më sot, që rezulton me efektivitet substancial për masat parandaluese. Pra, është një shenjë shumë e mirë, që tregon se vendi ynë e ka çuar në një nivel tjetër çështjen e parandalimit, por ato mangësi dhe ato problematika që vërehen janë kryesisht në qasjen represive ose në qasjen e dënimeve. Në bazë të rekomandimeve të këtij komiteti ka nisur menjëherë puna për adresimin e tyre.

Më 4 shtator të vitit 2018 është mbledhur Komiteti për Bashkërendimin e Luftës kundër Pastrimit të Parave, i cili drejtohet nga Kryeministri dhe ka anëtarë të gjithë aktorët relevantë në vend, ministra që kanë lidhje me fushën përkatëse, Prokurorin e Përgjithshëm, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, drejtorin e Shërbimit Informativ dhe inspektorin e Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Ky komitet ka miratuar planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve, duke caktuar për çdo institucion përgjegjës masa dhe afate. Pra, ky plan është në proces zbatimi.

Aktualisht, në bazë të këtij plani, kemi bërë gati projektligje me ndryshime, të cilat priten të kalojnë pranë Këshillit të Ministrave dhe më pas në Kuvend. Sipas planit të veprimit, por edhe në bazë të pritjeve tona projektligjet duhet të jenë të miratuara nga Kuvendi në periudhën mars-prill 2019 dhe më pas brenda muajit qershor duhet synuar që të miratohen aktet nënligjore në zbatim të tyre për t'i lënë kohë edhe vlerësimit të efektivitetit të tyre.

Në kuadër të zbatimit të këtij plani vlen për t'u përmendur angazhimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nisja e punës për krijimin e dy regjistrave shumë të rëndësishëm: regjistri i llogarive bankare dhe regjistri i pronarëve përfitues. Këta dy regjistra, që janë parashikuar të ndërtohen, do të implementohen në një periudhë afatmesme, dy apo trevjeçare.

Ngritja e këtyre regjistrave pritet të ketë një impakt të ndjeshëm në luftën e parandalimit dhe pastrimit të parave, por edhe me çështje të tjera, që lidhen me FISK-un apo me transparencën e pronarëve përfitues.

Për sa i përket bashkëpunimit me organet e zbatimit të ligjit, prokurorinë dhe policinë, por edhe me SHISH-in, dua t'ju informoj se gjatë vitit 2018 janë referuar rreth 376 raste nga drejtoria jonë, nga të cilat 343 raste në Policinë e Shtetit dhe 33 raste janë referuar direkt në prokurori. Mesatarisht janë 1,5 raste për çdo ditë pune të referuara.

Drejtoria jonë ka synuar thellimin e analizës së informacionit dhe plotësimin e tij me të dhëna shtesë nga organet ligjzbatuese dhe subjektet brenda vendit, gjithashtu edhe nga homologët jashtë vendit. Nga 343 rastet e dërguara në polici, 127 prej tyre kanë shërbyer si indicie për referimet e bëra nga policia për nenin 287 të Kodit Penal. Gjithashtu, 91% e raportimeve ose referimeve të bëra vijnë nga raportimet e aktivitetit të dyshimtë, një tregues ky i efikasitetit të lartë të sistemit parandalues në vend.

Gjatë vitit 2018 janë nxjerrë 24 urdhra bllokimi të përkohshëm për fonde në llogari bankare, me një vlerë totale rreth 5,4 milionë euro, prej të cilave janë sekuestruar me vendim gjykate rreth 4,5 milionë euro. Gjithashtu, në bazë të indicieve të dërguar nga drejtoria, në funksion të gjurmimit të aseteve të dyshuara me prejardhje kriminale, nga të dhënat paraprake të ndara nga Policia e Shtetit, rezulton se janë sekuestruar rreth 5 milionë euro pasuri të paluajtshme, duke e çuar në total vlerën e aseteve të sekuestruara me indicie nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në 9,5 milionë euro.

Bazuar në komunikimet që kemi pasur me Policinë e Shtetit, ka rezultuar se gjatë vitit 2018 janë sekuestruar në total 38,2 milionë euro pasuri të paluajtshme, para fizike dhe llogari bankare të dyshuara si të gjeneruara nga aktivitete kriminale. Rreth 21,5 milionë euro prej tyre lidhen direkt me pastrimin e parave.

Nga dhënat që kemi në dispozicion rezulton se pothuajse të gjitha rastet e sekuestrimeve të fondeve në llogari bankare të evidentuara nga policia kanë indicie nga rastet e dërguara nga drejtoria jonë. Gjatë vitit 2018, në përgjigje të kërkesave të policisë, janë kryer verifikime për rreth 2800 persona ose 12% më shumë krahasuar me një vit më parë. Në total gjatë gjithë vitit kemi kryer verifikime për 4552 persona, një rritje e ndjeshme krahasuar me vitet e mëparshme. Veçanërisht në 2-3 vjetët e fundit ka pasur një rritje të numrit të personave dhe kërkesave për

verifikim të kryer nga drejtoria jonë, duke qenë rreth 3 herë më shumë se mesatarja e 4 vjetëve të mëparshëm, pra për periudhën 2012-2016.

Për sa i përket bashkëpunimit me Shërbimin Informativ Shtetëror, vlen të theksohet se është shumë i mirë dhe frytdhënës në kuadër të orientimit të fushave reciproke të veprimtarisë në mbrojtjen e sistemit financiar në tërësinë e tij, luftën kundër krimit të organizuar dhe parandalimin e radikalizmit apo financimit të terrorizmit.

Për sa i përket bashkëpunimit tonë me organet tatimore dhe doganore, vërehet një bashkëpunim në rritje si në dërgimin e rasteve të dyshimta të dërguara prej tyre, ashtu edhe në rritjen e sensibilizimit, risqet e posaçme, që lidhen me fushën e veprimtarisë së tyre, gjithashtu edhe në trajtimin e rasteve të dërguara nga drejtoria jonë.

Në bazë të të dhënave paraprake rezulton se gjatë vitit 2018 nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë rikuperuar rreth 34,4 milionë lekë, në bazë të informacioneve të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Gjithashtu, nga rastet e sinjalizuara janë gjithsej 17 raste që janë dërguar për vlerësim tatimor, ku vlera e dyshuar si e padeklaruar është rreth 482 milionë lekë. Pra, 34 milionë lekë janë të rikupëruara, ndërkohë 482 milionë lekë janë në proces rivlerësimi tatimor në bazë të informacioneve që ka dërguar drejtoria jonë. Në rastet që ne kemi dërguar dhe kemi ndarë me tatimet rezulton se 7 raste janë dërguar për kallëzim penal.

Për sa i përket bashkëpunimit me organet mbikëqyrëse, në përgjithësi kemi bashkëpunim të mirë me Bankën e Shqipërisë, me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si dhe me Ministrinë e Drejtësisë. Niveli i bashkëpunimit me këto organe është në nivel të mirë dhe ka qenë i qëndrueshëm dhe i fokusuar kryesisht në organizmin e inspektimeve të përbashkëta dhe kontributin e dhënë, gjithashtu, edhe në procesin e vlerësimit nga komiteti Moneyval. Gjithsesi, gjykojmë se ka ende vend në forcimin e mbikëqyrjes, në rritjen e nivelit të formalizimit dhe sensibilizimit të disa kategorive të subjekteve të ligjit dhe për këtë jemi duke nxitur për bashkëpunim autoritetet përkatëse mbikëqyrëse.

Për sa i përket bashkëpunimit me autoritet ndërkombëtare, kemi vijuar të shkëmbejmë informacione në nivel inteligjence me homologët jashtë vendit, si dhe në mënyrë të posaçme kemi bashkëpunim pozitiv me strukturat partnere brenda vendit, me misionin OPDAT dhe me ekspertët e FBI-së, në kuadër të operacionit “Forca e ligjit”.

Kërkesat për informacion nga homologët dërguar nga drejtoria jonë arritën në 103 gjatë vitit 2018 kundrejt 74 që ishin një vit më parë dhe kundrejt një mesatareje prej 55 kërkesash në vit për periudhën 2013-2017.

Për sa u përket kërkesave të marra për informacion nga homologët, ato ishin 97 gjatë vitit 2018 kundrejt 79 kërkesave të një viti më parë dhe një mesatare rreth 70 kërkesa në vit për periudhën 2013-2017.

Për sa u përket raportimeve të subjekteve në drejtorinë tonë të inspektimeve gjatë vitit 2018, ka një rritje prej 10% të rasteve të dyshimta të raportuara nga subjektet e ligjit. Pra, në total janë raportuar 1525 raporte aktivitetesh të dyshimta kundrejt 1384 që ishin gjatë vitit 2017. Gjithashtu, gjatë këtij viti ka një rritje me 6% të numrit të inspektimeve nga drejtoria jonë të kryera për subjektet e ligjit krahasuar me vitin 2017. Gjatë këtij viti kemi kryer 182 inspektime kundrejt 171 të një viti më parë. Këtu dua të shpjegoj se 65% e inspektimeve janë bërë në distancë; 73% e tyre janë përqendruar si subjekte me risk të lartë dhe pjesa tjetër është e fokusuar në subjektet me risk mesatar apo të ulët. Pra, këtu është shumë e rëndësishme të theksojmë se puna e mbikëqyrjes orientohet në bazë të riskut. Veçanërisht vlen të evidentohet rritja e inspektimeve për noterët, ku gjatë vitit 2018 janë inspektuar 49 noterë kundrejt 23, që ishin një vit më parë. Këto inspektime të kombinuara edhe me trajnimin, kanë ndikuar edhe në rritjen, pothuajse me dyfish, të rasteve të dyshimta të raportuara nga noterët në drejtorinë tonë, të cilat kanë arritur në nivelin më të lartë historik. Gjithashtu, vërehet një përmirësim i përputhshmërisë së subjekteve raportuese me detyrimet ligjore.

Gjatë vitit 2018 ka rezultuar mesatarisht 1 në 10 inspektime me masë administrative kundrejt 1 në 7 inspektime, që ishin në vitin 2018 dhe kundrejt mesatares 1 në 4 inspektime që ishte në periudhën 2013-2016. Në total gjatë vitit 2018 kemi aplikuar 18 masa administrative, me një vlerë totale prej 14,2 milionë lekësh. Peshën kryesore nga subjekte e gjobitura e zënë shoqëritë e ndërtimit ndaj të cilave janë aplikuar 10 masa me vlerë totale 9,8 milionë lekë dhe më pas janë ndjekur nga noterët me 4 masa administrative me vlerë totale 2,8 milionë lekë. Në total nga drejtoria jonë, përtej masave administrative të vendosura gjatë këtij viti, janë arkëtuar 22,6 milionë lekë detyrime të viteve të mëparshme.

Një element tjetër i rëndësishëm i punës sonë ka të bëjë me trajnimin e subjekteve të ligjit, ku gjatë vitit 2018 janë trajnuar 702 persona, individë punonjës të subjekteve raportuese, kundrejt

600 personave, që ishin një vit më parë. Synimi ynë ka qenë të prekim pothuajse të gjithë gamën e subjekteve, por fokusi patjetër që është tek ato me risk të lartë.

Elementet e mësipërme kanë një impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë e informacionit të dërguar nga drejtoria jonë dhe për rrjedhojë edhe në mënyrën direkte dhe indirekte të bashkëpunimit me organet e zbatimit të ligjit dhe me ato të inteligjencës.

Në qoftë se do të ndalemi te pjesa e buxhetit të DPPP-së, falë edhe mbështetjes së këtij komisioni, buxheti i drejtorisë sonë gjatë vitit 2018 për investime arriti vlerën 17,5 milionë lekë, që është vlera më e lartë historike. Investimet gjatë këtij viti u realizuan në masën 96%. Synimi dhe përparësia jonë gjatë këtij vitit, por edhe në vitet në vijim është të fokusohemi te përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe rrjeteve të sigurisë.

Ky ishte raporti në vija të përgjithshme, në qoftë se keni pyetje ose nevojë për detaje të mëtejshme jemi të hapur.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gjokutaj, për paraqitjen e këtij raporti nga ana juaj! Për më tepër, do të vlerësoja faktin se bëtë një paraqitje të përmbledhur, duke u dhënë kohë anëtarëve të komisionit për të shtruar të gjitha pyetjet që ata kanë në lidhje me veprimtarinë tuaj përgjatë vitit 2018. Nga ana tjetër, besoj se na e bënë të gjithëve më të lehtë komunikimin dhe marrjen e përgjigjeve për pyetjet, por edhe fakti që ju i keni bashkëngjitur raportit edhe të dhënat statistikore, që nuk janë thjesht të dhëna statistikore, të cilat lidhen me vitin 2018, por kohështirja e tyre është e mjaftueshme për të vlerësuar sa dhe si duhet për të bërë një gjykim objektiv të performancës së punës së institucionit tuaj, sepse këto të dhëna zënë fill që nga viti 2013 deri në vitin 2018.

Sipas Rregullores së Kuvendit, në këtë moment fjala është për anëtarët e komisionit, të cilët kanë dëshirë të drejtojnë pyetje.

Po, zoti Duzha.

Luan Duzha – Faleminderit kryetare!

Faleminderit, drejtor, për raportin e paraqitur!

Në raport thuhet se janë sekuestruar rreth 38,2 milionë euro pasuri të luajtshme apo para fizike, ndaj unë kam një pyetje: sa nga këto para janë konfiskuar dhe kanë kaluar në buxhetin e shtetit?

Faleminderit!

Arlind Gjokutaj – Unë ju falënderoj për pyetjen. Është një pyetje me vend, por këto raste sekuestrimesh janë raste të procesit të nisur gjatë këtij viti. Zakonisht proceset për konfiskimin janë procese që zgjasin më shumë se një vit dhe të them të drejtën as ne nuk kemi informacion për numrin final të konfiskimeve të bëra gjatë vitit 2018.

Nuk mund të jap asnjë shifër të saktë, pasi nuk kemi të dhëna në lidhje me konfiskimin për shkak se proceset zgjasin dhe janë procese që shkojnë përtej vitit, por duke e krahasuar edhe me vitet e mëparshme, jemi në fazën e koordinimit dhe të mbledhjes së të dhënave edhe nga autoritetet e tjera, pasi e kemi më të lehtë për të mbledhur të dhënat kuadër të konfiskimeve në kuadër të ligjit antimafie, për shkak se është agjencia përkatëse që i administron. Ndërkohë është disi më e vështirë dhe më e fragmentarizuar mbledhja e të dhënave statistikore për konfiskimet në proces penal.

Ermonela Felaj - Ne do të kemi rastin, në fakt, të shohim edhe raportin e Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2018 dhe ndoshta kjo do të na japë mundësinë që të bëjmë një ballafaqim të të dhënave që na jepni ju. Ne do të kemi një dëgjues me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të dhënat e kriminalitetit për vitin 2018. Një pjesë nga ne ka qenë prezent gjatë prezantimit që është bërë në mjediset e Akademisë së Sigurisë dhe, natyrisht, është rasti që të gjithë atë informacion ne ta ndajmë dhe ta ballafaqojmë me publikun.

Fjala për zotin Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

E falënderoj drejtorin për raportin korrekt dhe shterues!

Natyrisht që e vlerësoj përmbushjen e pjesës më të madhe të rekomandimeve që keni marrë, si dhe përmbushjen e buxhetit, që e miratuam të gjithë bashkë në vlerën 17.5 milionë, për të përmbushur të gjitha detyrat në fushën logjistike.

Po lexoja raportin, në tabelën ku tregohen rastet referuar organeve të zbatimit të ligjit, nga viti 2013 deri në vitin 2018 shikoj një rënie për sa u përket referimeve në prokurori. Referimet në polici kanë një rritje prej 27%, ndërsa referimet në prokurori janë 33%, pra jemi pothuajse në ato raporte si në vitin 2013. Cila është arsyeja?

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zoti Gjokuta.

Arlind Gjokuta – Ju falënderoj për pyetjen!

Numri i referimeve të dërguara nga njësia jonë në prokurori ka pasur rënie, sepse bashkëpunimin kryesisht e kemi me policinë. Njësia jonë niset nga indicia anomali në transaksione, që më pas plotësohet nëpërmjet punës hetimore të bërë nga policia për të çuar një referim të plotë në prokurori.

Rënia e numrit të rasteve lidhet edhe me synimin tonë për plotësimin e dosjes me më tepër detaje në informacion në mënyrë që të rrisim gjasat për sukses të rasteve që policia dërgon në prokurori.

Nga raporti i vlerësimit “Manival”, por edhe nga analiza e bërë ndër vite rezulton që, pavarësisht numrit të lartë të rasteve të dërguara në prokurori, numri i rasteve që përfundon për gjykim ka qenë në nivelin 7-8 raste në vit. Me ndryshimin e kësaj qasje në dy vjetët e fundit, e cila ka nisur si filozofi pune që një vit më parë, numri i rasteve të çuara për gjykim ka qenë 31 në vitin 2017 dhe 17 raste në vitin 2018. Pra, flasim për raste për pastrim parash. Nëse bëjmë një përmbledhje, në 2 vjet janë dërguar për gjykim 48 raste kundrejt 41 rasteve të dërguara në total në 6 vjetët e mëparshme. Ne mendojmë se në këtë përmirësim të eficiencës ka ndikuar edhe mënyra e trajtimit dhe e referimeve të bëra. Pra kemi synuar bashkëpunim të ngushtë me policinë me dërgimin e rasteve dhe krijimin e grupeve të përbashkëta, të cilat kanë hetuar grupe dhe raste të posaçme, që materiali i dërguar në prokurori të jetë sa më i plotë, duke rritur më pas edhe shanset për sukses.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gjokuta!

Fjala është për zonjën Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj drejtorin e përgjithshëm të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave për prezantimin dhe njëkohësisht edhe administratën, e cila ka punuar në funksion të realizimit të misionit dhe arritjeve, të cilat u bënë prezente në komision.

Në fjalën tuaj ju thatë se gjatë vitit 2018 janë kryer investime në fushën e teknologjisë së informacionit, të rrjeteve dhe sigurisë, ku realizimi është paraqitur në masën 96%. Pyetja ime është: për përmirësimin e mëtejshëm të punës suaj, si dhe për arritjen e standardeve të larta të sigurisë, a keni parashikuar fonde të tjera?

E dyta, burimet njerëzore a i keni të mjaftueshme dhe a janë të trajnuar për të realizuar misione në drejtim të luftës kundër terrorizmit dhe misionit që ka institucioni juaj?

Faleminderit!

Arlind Gjokuta – Ju falënderoj për pyetjen!

Për sa u përket fondeve, për vitin 2018 arritëm vlerën maksimale prej 17,5 milionë lekësh në investime, ndërkohë që për vitin 2019 buxheti i DPP-së për investime është 25 milionë lekë. Pra, kemi një rritje të ndjeshme krahasuar me vitet e mëparshme. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kemi rënë dakord që investimet për një periudhë 2 apo 3-vjeçare të jenë në të njëjtin nivel, pra mesatarisht me rreth 25 milionë lekë në vit, në mënyrë që të krijojmë një infrastrukturë të teknologjisë së informacionit në ato standarde dhe nivele që ne dëshirojmë, në mënyrë që të përmbushim të gjitha çështjet e sigurisë.

Për sa u përket burimeve njerëzore, kjo është një pyetje me vend, sepse drejtoria jonë gjatë viteve të fundit ka pasur një *turn over* të lartë të stafit, pra lëvizje të larta, çështje, të cilat i kemi adresuar edhe te Ministria e Financave, ku kemi bërë një kërkesë, sipas rekomandimit nga komuniteti “Manival” i Këshillit të Europës, që kërkon rritje të stafit për drejtorinë tonë për sa i përket inspektimit.

Stafi në tërësi është vlerësuar si i kualifikuar. Puna e drejtorisë, siç del edhe nga raporti i vlerësimit “Manival”, tregon që është në eficiencë të lartë, por ka nevojë për rritje të numrit të stafit të inspektimit. Drejtoria jonë është vlerësuar si ndër të vetmet që zbatojnë në mënyrë rigoroze mbikëqyrjen e subjekteve.

Dua t’i bëj me dije komisionit që ne jemi një institucion komplementar në mbikëqyrje, pasi në bazë të ligjit jemi mbikëqyrësit primarë që mbikëqyrin çdo subjekt, por, duke qenë se stafi i drejtorisë sonë është i specializuar për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, është gjykuar me vend që të ketë një rritje të stafit, në mënyrë që të përmbushim sa më mirë detyrimin e subjekteve për mbikëqyrje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, drejtor!

Unë e konsideroj të saktë materialin shumë analitik që keni paraqitur edhe me shifra, ku zënë fill edhe pyetjet e mia. Po ta shikojmë me kujdes, nga viti në vit ka pasur bllokime, por nga viti 2017 deri në vitin 2018 kemi një rënie të numrit të bllokimeve, pra nga 52 në 24. Si mendoni,

pse ka ardhur kjo rënie? Sa prej këtyre bllokimeve janë konsideruar të sakta, pra që nuk është bërë ankimim në gjykatë, dhe sa prej tyre janë zhbllokuar me vendim gjykate?

Pyetja e dytë, ju keni operuar edhe me autoritete të tjera, si me ILDKPI-në, DSIK-në dhe institucione të tjera, madje ju thoni se u jeni përgjigjur këtyre institucioneve për rreth 288 persona. Ky numër është numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve gjatë periudhës së vetingut, apo janë kategori të tjera individësh që këto autoritete kanë kërkuar informacion?

Faleminderit!

Arlind Gjokuta – Faleminderit për pyetjet!

Për sa i përket çështjes së bllokimeve, është e vërtetë që ka një rënie të numrit të bllokimeve, por duhet kuptuar se urdhrat e bllokimit që nxjerr drejtoria janë nxirren në kushtet kur ka një emergjencë ose kur ka rrezik dalje të fondeve jashtë sistemit. Pra, parimi që ne ndjekim në këtë rast është gjurmimi i fondeve dhe monitorimi i tyre për të kuptuar të gjithë rrethin e personave të përfshirë, në mënyrë që investigimi të jetë sa më i plotë. Këto janë rastet që gjeneron sistemi. Por duhet të kemi parasysh që me shtrëngimin e masave, subjektet, personat ose individët, që tentojnë të bëjnë veprimtari për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, janë më të kujdesshëm dhe më të sofistikuar në mënyrën e kryerjes së transaksioneve.

Raporti i fondeve të bllokuara me fondet e sekuestruara është në tabelë. Gjatë këtij viti ky raport ka arritur vlerën më të lartë, pra krahasuar me numrin e rasteve që kemi bllokuar, me bllokim të përkohshëm, rreth 84% të rasteve janë sekuestruar me vendim gjykate. Kjo tregon një rritje të eficiencës.

Siç theksohet edhe në raport, vërtet janë 5,4 milionë euro fonde të bllokuara në llogari bankare, por nëpërmjet informacionit, për rastet e hetuara, janë rreth 5 milionë euro të tjera, përveç fondeve në llogaritë bankare, që janë sekuestruar nga policia. Pra, ne nuk kemi nxjerrë një urdhrë bllokimi për pasuri të paluajtshme për shkak se risku menaxhohet dhe nuk ka mundësi për tjetërsim të pasurisë, por kemi dërguar informacionin në polici. Në total vlera e fondeve të sekuestruara nisur nga rastet emergjente të gjykuara nga drejtoria janë ka qenë rreth 9,5 milionë euro. Në tërësi numri i hetimeve dhe shumat e përfshira janë të ndryshme, sepse ka hetime që zgjasin për një kohë të gjatë, pra ka llogari apo individë që mbahen në monitorim të vazhdueshëm. Pra për shkak të procesit të mbikëqyrjes ka raste që nuk nxirret urdhrë bllokimi për të evituar dekonspirimin e hetimit.

Për sa i përket numrit të verifikimeve për ILDKPI-në, DSIK-në apo për autoritete të tjera, numri me 288 persona nuk ka lidhje me rastet e prokurorëve dhe gjyqtarëve, por me verifikimet që kryejnë këto institucione në kuadër të punës së tyre.

Për sa i përket detyrimit për verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, drejtoria jonë e ka kryer këtë gjatë vitit 2017. Në kuadër të kërkesave të ILDKPI-së, drejtoria jonë kreu verifikimet brenda një muaji për të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe të afërmit e tyre. Materiali i është dërguar ILDKPI-së dhe bashkëpunimi vijon rast pas rasti sipas grupeve që dalin përpara vetingut. Pra, ne bëjmë rifreskimin e të dhënave që i kemi dërguar fillimisht ILDKPI-së, në bazë të prioriteteve të KPK-së.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Braho.

Spartak Braho – Edhe unë kam të njëjtin mendim për aktivitetin e saktë dhe të dobishëm që bëni, por në raportin tuaj nuk merr përgjigje një pyetje, të cilën do ta bëj direkt. A pastrohen para në Shqipëri, apo jo? A keni ndonjë indicie për banka që pastrojnë para në Shqipëri?

E treta, ju thatë që keni një bashkëpunim të mirë me agjencitë ligjzbatuese, sa njerëz janë dënuar në Shqipëri për pastrim parash?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Braho, për pyetjen!

Arlind Gjokuta – Faleminderit!

Për sa i përket pyetjes së parë, mendoj se nuk ka asnjë vend të botës që nuk pastrohen para. Pastrimi i parave është një proces i vazhdueshëm, sepse për çdo të ardhur nga aktivitetet kriminale ose nga veprat penale, që gjenerojnë të ardhura, automatikisht fillon një indicie për pastrimin e parave. Çështja është se sa efektiv janë autoritetet e një vendi në parandalimin dhe luftën e këtij fenomeni. Pastrim parash ka edhe në Korenë e Veriut, pra është e vështirë që një vend të jetë i mbrojtur. Mjafton të shikojmë skandalet e mëdha që po ndodhin kohët e fundit në vendet e BE-së, si përfshirja e bankave të mëdha në çështjet e pastrimit të parave, kemi rastin e bankës nordike Danske Bank, kemi bankën e tretë më e madhe në Lituanë, e cila u vendos në listën e sanksioneve të Amerikës dhe u detyrua që të mbyllet, sepse ishte e përfshirë në pastrimin e parave që rridhnin nga aktivitete kriminale të ndryshme në Rusi dhe së fundi kemi Suede Bank, e cila është përfshirë në hetim për këtë çështje. Pra, procesi i pastrimit të parave është një proces që do të vijojë, por e rëndësishme për autoritetet është që të jenë të ndërgjegjshme për risqet sektoriale

që ka vendi dhe për risqet që mbartin subjekte të caktuara në çështjet e parandalimit dhe pastrimit të parave dhe ka për detyrë hetimin, konfiskimin e aseteve dhe dënimin.

Për sa i përket pyetjes a ka indicie për bankat që pastrojnë para, nëse do të kishte, patjetër do të kishte referime të bankave që pastrojnë para. Por duhet të kemi parasysh që çdo institucion financiar, bankat, zyrat e këmbimit dhe shoqëritë e transfertave mund të shërbejnë si institucione për pastrimin e parave nga individë të tretë, ndërsa, kur ka raste për përfshirjen e bankave, ky është një aktivitet shumë i rrezikshëm dhe merren masa nga drejtoria jonë dhe autoritetet mbikëqyrëse. Për sa kohë që unë ushtroj detyrën, nuk kam informacione për banka të përfshira në procese të pastrimit të parave.

Për sa u përket dënimeve nuk kemi një shifër përfundimtare, sepse jemi në fazën e mbledhjes për dy vjetët e fundit, por nga të dhënat që kemi pasur ndër vite janë rreth 85% të rasteve të dërguara në gjykatë, pra nga 31 raste, duhet të jenë rreth 26 raste që kanë përfunduar me dënim. Ne jemi në fazën e mbledhjes së këtij informacioni, sepse drejtoria jonë nuk i disponon dhe nuk i merr dot menjëherë, meqenëse janë të shpërndara në gjykatat ku janë gjykuar.

Spartak Braho – Përgjigjja ishte kontradiktore, meqenëse pranoi se këtu pastrohen para dhe paratë pastrohen në banka, por ju nuk keni evidentuar banka që pastrojnë para. Shikojeni mirë këtë punë, se paratë pastrohen dhe bjerini në kokë këtij problemi.

Ermonela Felaj – Po, zoti Gjokuta.

Arlind Gjokuta – Unë flas në emër të raportimeve që marrim, çdo informacion i ri që mund të kemi në këtë drejtim vlerësohet. Këtu po diskutojmë a kemi të dhëna për banka të përfshira apo jo, pra jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe unë thashë që bankat shërbejnë për pastrimin e parave kudo në botë, pasi procesi i pastrimit të çdo fondi të gjeneruar nga aktivitetet kriminale bëhet në ato institucione ligjore. Pra, për sa kohë që ajo para qarkullon në informalitet, vazhdon të quhet “para e pisët” dhe që ky proces të quhet pastrim duhet që këto para të futen në kanalet zyrtare. Këto para futen në kanale zyrtare me apo pa vetëdijen e bankës, por ne nuk kemi të dhëna që këto veprime të bëhen me vetëdijen e bankës.

Ermonela Felaj – Zoti Gjokuta, ta zgjerojmë pak edhe pyetjen dhe përgjigjen e zotit Braho. Ju në raportimin tuaj shprehët që keni kaluar një vlerësim të rëndësishëm nga “Manival”, i cili është një ndër instrumentet më të rëndësishëm që ka Këshilli i Europës për të vlerësuar luftën kundër financimit të terrorizmit, pastrimit të parave dhe të gjitha produkteve që rrjedhin nga një

veprimtari kriminale, sepse jo domosdoshmërisht produktet janë në të holla, a mund të na thoni diçka më tepër për këtë?

Ky nuk është rasti i parë që institucioni juaj ka kaluar në filtrin e “Manival”, pra si e ka vlerësuar ndër vite institucionin tuaj dhe si është vlerësuar institucioni bankar në Shqipëri nga ky institucion? Masat që duhet të merren për të pasur një përputhje të plotë me rekomandimet e “Manival” a lidhen edhe me bankat?

Ju thatë që duhet të bëni regjistrin e llogarive bankare dhe regjistrin e pronarëve përfitues, në një kohë që nuk duket se është e shkurtër, a mund të na thoni dy fjalë për secilin nga këta regjistra? Çfarë presupozohet të parandalojë njëri dhe çfarë prezupozohet të parandalojë tjetri? Si do të ndikojë ngritja e këtyre dy regjistrave në luftën kundër pastrimit të parave?

Arlind Gjokuta – Në fakt, ka nevojë për sqarime, sepse një pjesë e përgjigjes së zotit Braho mund të gjendet edhe në raportin e vlerësimit “Manival”, ku Shqipëria kaloi raundin e pestë të vlerësimit. Përpara këtij vlerësimi që u bë në 2-vjetët, e fundit ka pasur edhe katër raunde të mëparshme, që janë kryer çdo katër vjet. Vlerësimi i fundit ka qenë gjatë viteve 2010-2011 dhe ju kujtoj që pas atij vlerësimi vendi ynë hyri automatikisht në listën gri, ose në listën e vendeve me mangësi në trajtimin e çështjeve të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në këtë raund vlerësimi kemi një metodologji të re, shumë të ndryshme nga metodologjia e parë dhe shumë më shtrënguese. Raundet e mëparshme të vlerësimit bazoheshin vetëm në vlerësimin e përputhshmërisë teknike, pra sa i përputhur ishte kuadri rregullator, që lufton dhe parandalon pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në vend me standardet ndërkombëtare. Në këtë raund vlerësimi është futur një element i ri për matjen e efektivitetit, pra në zbatimin e këtij kuadri rregullativ.

Vlerësimi i efektivitetit është një çështje thelbësore, ku të gjitha vendet e vlerësuara deri më sot kanë shfaqur mangësi.

Për sa i përket pjesës teknike, unë e përmenda që kemi një rezultat relativisht shumë të mirë krahasuar me disa vende të BE-së, por kemi disa mangësi në zbatimin e efektivitetit dhe ky rezultat është në linjë me mesataren e vlerësimit të të gjitha vendeve, pra 12 vendeve të vlerësuara deri më sot nga Manival-i.

Ky rezultat, për sa i përket efektivitetit, përveç mangësive që thamë në numrin e ulët të dënimeve, numrin e konfiskimeve apo boshllëkun ligjor që ekziston për sanksionet e financuesve evidenton një element shumë të rëndësishëm, efektivitetin e sistemit parandalues (kjo mund të jetë

një përgjigje për pyetjen e zotit Braho), pra masat që marrim, dhe sistemi parandalues në vendin tonë, për shkak edhe të strukturës së re apo zhvillimit financiar në mënyrë thelbësore, janë bankat.

Masat që marrin bankat për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë gjykuar nga ekspertët e këtij komisioni me efektivitet shumë të lartë.

Janë mbi 50 vende të vlerësuara në botë me këtë metodologji, ndërkohë që Shqipëria dhe Armenia janë vlerësuar me efektivitet substancial për sa u përket masave parandaluese.

Gjithashtu, është vlerësuar me efektivitet substancial edhe puna e njesisë së inteligjencës financiare. Lufta ndaj fenomenit të pastrimit të parave, po fokusohet këtu, por edhe financimi i terrorizmit, normalisht kryet në dy shtylla, pra është kombinim i dy mënyrave:

1. Qasja parandaluese.
2. Qasja represive ose ndëshkuese.

Të dhënat që kemi ndër vite tregojnë se vendi ynë ka progres dhe performon mirë në qasjen parandaluese, por kemi mangësi, të cilat janë duke u adresuar për sa i përket qasjes ndëshkuese.

Është një raport i detajuar me rreth 200 faqe, që tashmë është publik.

Për sa u përket dy regjistrave, theksoj se dy regjistrat nuk janë detyrim që vjen nga rekomandimet e Manival-it, por janë detyrim që lindin nga direktiva 4 dhe 5 e BE-së për pastrimin të parave dhe financimin e terrorizmit, por vendi ynë nuk ka asnjë detyrim të ketë një implementim të tyre në një periudhë afatshkurtër, ose më pas, me nisjen e proceseve integruese mbase do të duhet, tregon rëndësinë dhe vëmendjen që kanë autoritetet shqiptare ndaj këtyre proceseve.

Ngritja e këtyre regjistrave do të përmirësojë ndjeshëm punën në drejtim të efektivitetit. Regjistri i pronarëve përfitues do të jetë një regjistër publik, ku do të kenë akses drejtpërdrejt autoritetet e ndryshme që hetojnë rastet dhe ky regjistër zbardh strukturën e pronësisë të çdo subjekti juridik që ushtron veprimtari në territorin e RSH-së. Pra, shkon deri te individit që ka kontrollin final në nivelin 25%. Nëse keni parasysh një subjekt juridik që kontrollohet nga një subjekt juridik tjetër dhe ky i fundit kontrollohet nga një subjekt tjetër juridik, në momentin e ndërtimit të këtij regjistri do ta kemi të zbardhur deri te individit final që qëndron prapa kontrollit efektiv të shoqërisë së parë, në nivelin 25%.

Mendoj se kjo është një iniciativë shumë e mirë për vendin tonë dhe në momentin që do të zbatohet, përveçse do të rrisë transparencën edhe karshi publikut, gazetarëve apo investigimeve

të ndryshme që mund të bëjnë, do të rrisë ndjeshëm edhe aksesin e informacionit që kanë organet ligjzbatuese apo organet e inteligjencës në hetimin e rasteve të dyshimta.

Për sa i përket regjistrit të llogarive bankare, me strukturën e bankave që ne kemi, informacioni i regjistrit nga drejtoria jonë aksesohet në një kohë relativisht të shpejtë, pra nuk ka probleme në kohë, pasi jem një vend me një sistem të vogël bankar, ka pak banka. Për shkak të detyrimeve që kanë bankat e ofrojnë në mënyrë të shpejtë informacionin, por është një regjistër që do ta ndikojë së tepërmi punën, pasi do të përdoret edhe për qëllime fiskale apo për qëllime të tjera.

Duhet të jemi të qartë se ky regjistër do të ketë të dhëna se sa llogari dhe bankat ku i ka një individ apo një subjekt juridik, pro nuk do të ketë të dhëna për gjendjen e llogarive.

Duke pasur këtë regjistër rritet efienca dhe kursehet kohë. Po jap një shembull. Sot, nëse kemi dyshime për një individ të caktuar apo për një subjekt juridik, u dërgohet kërkesë të gjitha bankave për të nxjerrë llogaritë e tyre. Nëpërmjet këtij regjistri identifikohen vetëm ato një, dy apo tri banka ku mund të ketë llogari individit dhe në këtë mënyrë, përveçse përfitohet në kohë, gjithashtu ulet edhe gjasat për dekonspirimin apo daljen e informacionit gjatë hetimit.

Ermonela Nelaj – Kush do t'i administrojë këta dy regjistra? Ju?

Arlind Gjokutaj – Nuk është vendosur akoma. Ne kemi aplikuar.

Ermonela Felaj – Si është modeli në vendet që i kanë këto regjistra?

Arlind Gjokutaj – Ka modele të ndryshme. Për sa i përket regjistrit të pronarëve përfitues ka vende që kanë krijuar autoritet më vete, por deri tani, siç është gjykuar këtu, është menduar që mund t'i përshtatet struktura e Qendrës Kombëtare të Biznesit, por gjithsesi kemi aplikuar për asistencë nga BE-ja, nëpërmjet TAIEX-it dhe pritet që muajin e ardhshëm do të vijjnë ekspertët përkatës të BE-së, të cilët do të bëjnë një analizë të bazës ligjore në vend dhe do të japin rekomandimet përkatëse për mënyrën e ngritjes dhe e funksionit të këtyre regjistrave.

Për sa i përket regjistrit të llogarive bankare eksperiencat janë mikse, pra nuk ka një qasje të unifikuar. Ka disa vende që e kanë të ngritur në bankat qendrore, disa vende të tjera e kanë të vendosur pranë Autoritetit Fiskal, ka edhe disa vende të tjera që e kanë si agjenci më vete. pra, ne kemi në një fazë të hershme, kemi marrë vendimin, kemi bërë disa analiza, kemi mbledhur informacion për vend të ndryshme se si e kanë implementuar këtë regjistër, por nuk ka ende një vendim se cili do të jetë autoriteti që do ta administrojë.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea - Faleminderit!

Në radhë të parë dëshiroj të falënderoj drejtorin bashkë me stafin për performancën shumë të mirë që ka bërë Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave gjatë vitit të kaluar, çka u reflektua edhe në raportin e fundit të Manival-it. Kam dy pyetje në lidhje me punën tuaj.

E para, meqenëse flitet shumë për influencat në vendet e tjera në Ballkan, përfshi edhe Shqipërinë, a keni parë ju ndonjë rast, nëpërmjet krijimit të shoqatave apo organizatave që të ketë një influencë për të përdorur mënyrën e pastrimit të parave?

E dyta, meqenëse ju bëni inspektive të vazhdueshme dhe është shumë e lavdërueshme edhe puna që keni bërë për delegimin e rasteve në polici, a mendoni se ka boshllëqe ligjore, të cilat ia vlen të plotësohen dhe që një farë mënyrë ju ndihmojnë edhe ju në punën tuaj?

Në rast se po, ju i drejtoni diku propozimet tuaja për këtë vakuum ligjor dhe a keni një task forcë të krijuar në lidhje me këtë?

Ne si ligjvënës në këtë rast mund t'ju ndihmojmë.

Faleminderit!

Arlind Gjokutaj – Ju falënderoj për pyetjet dhe për komentet pozitive në kuadër të punës së punës së institucionit tonë!

Në lidhje me influencën, theksoj se kjo është një çështje që shkon përtej misionit dhe detyrave tona të përditshme.

Ne kemi bashkëpunuar dhe bashkëpunojmë me çdo institucion që e ka në fokus këtë çështje dhe kemi ndarë e do të ndajmë në vijim të dhënat që do të grumbullojnë në kuadër të kësaj, por është e pamundur që ne të bëjmë identifikim, pasi në mënyrë bazike ne jemi një vend i hapur. Le të themi, ne kontrollojmë flukset financiare, kemi tregti të lirë, kemi qarkullim të lirë të kapitalit dhe është e pamundur që ne të identifikojmë ndikimet nëpërmjet këtyre formave, nëse nuk kemi informacion nga organet përkatëse.

Për sa u përket inspektiveve, në fakt, gjetjet e inspektiveve tona kryesisht bazohen në mënyrën se si subjektet e ligjit (bankat, shoqëritë e transfertave, zyrat e këmbimit, noterët), se si këto subjekte e bëjnë zbatimin e kuadrit rregullativ, pra si i zbatojmë detyrimet e tyre në zbatim të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”.

Ndryshimet ligjore që janë parë të nevojshme si nga institucioni ynë, por edhe ato që kanë dalë si të nevojshme ose jo, në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare, janë adresuar me

paketën e ligjeve që përmenda në fillim, që është quajtur paketa Manival, ku janë rreth 4-5 ligje që preken të bëhen amendime jothelbësore dhe po bëhen dy ligje të reja.

Njëri ligj është “Për parandalimin e pastrimit të parave”, që do t’i vijë shpejt edhe këtij komisioni për mendim, pasi jemi në fazën e konsultimit me autoritetet publike, dhe ligji tjetër është “Për financimin e terrorizmit”.

Gjithashtu, po merren disa masa edhe në ligjin “Për regjistrimin në QKB”, ashtu edhe për procedurat tatimore. Ndërkohë po bëhen edhe dy ligje të reja. Ligji i parë ka të bëjë me sanksionet ndërkombëtare, kur ligji tjetër rregullon punën e Agjencisë së Administrimit të Aseteve të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Ermonela Felaj – Meqë jemi te ndryshimet ligjore për të cilat ju pyeti zonja Gjebrea, ndoshta koha e vlerësimit nuk është aq e gjatë sa për të qenë aq realistë në vlerësim, por sidoqoftë ndikimi unë besoj se ndihet dhe kuptohet. E kam fjalën për ligjin që mbylli lojërat e fatit. Dihet se lojërat e fatit janë ngritur kryesisht mbi bazën e të ardhurave që vinin nga aktiviteti kriminal. Ka disa muaj që ne e kemi votuar këtë ligj, ka disa muaj që të gjitha pikat e basteve apo lotot janë mbyllur në të gjithë Shqipërinë. Ndoshta, tek-tuk, dikush vazhdon ta kryejë këtë aktivitet, por në mënyrë të fshehtë. Unë do të doja të dija sa ka ndikuar ky ligj në veprimtarinë e institucionit tuaj? Ju keni një ndjeshmëri të caktuar për burimin kryesor të parave të dyshimta, nga cili lloj i aktivitetit kriminal gjenerohen këto para, po për rastin konkret a mund të kemi një opinion nga institucioni juaj?

Arlind Gjokutaj – Për sa u përket lojërave të fatit në vlerësimin kombëtar të riskut që ka koordinuar dhe udhëhequr institucioni ynë në vitin 2015, sektori i lojërave të fatit vlerësohej si një ndër sektorët me risk të lartë për pastrim parash dhe mendoj se kjo masë e ndërmarrë nga qeveria bazohet, përveç informacioneve të tjera të mbledhura gjatë periudhës më pas, por edhe në gjetjet e këtij raporti të vlerësimit të riskut.

Patjetër që mbyllja e tyre dhe prerja e aktivitetit, në një farë mënyre e lehtëson punën e institucionit tonë, por gjithsesi ne vazhdojmë të bashkëpunojmë me subjektet raportuese dhe të mbajmë në monitorim kryerjen e transaksioneve tashmë të jashtëligjshme nga këto subjekte. Kemi bashkëpunuar dhe kemi pasur edhe disa raste, ku përmes transaksioneve, pas mbylljes së aktivitetit, pra nga data 1 janar e këndej, kemi pasur sinjalizim nga subjektet e ligjit që kanë raportuar raste transaksionesh të lidhura me aktivitetet e lojërave të fatit për të cilat kemi marrë masa, kemi njoftuar policinë dhe ka pasur edhe veprime konkrete.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Duke parë grafikun e raportimit të aktiviteteve të dyshimta vë re se është rritur numri i raportimeve të noterëve, në 469 raste në vitin 2018 ose 85% më shumë dhe shihet se një ulje të numrit të rasteve nga ana e bankave. A mendoni që këto raporte janë reale dhe të sigurta? A ka bërë verifikime institucioni juaj mbi këto raporte? A keni konstatuar se ka një mospërputhje midis këtyre raportimeve dhe gjetjeve të institucionit tuaj?

Faleminderit!

Arlind Gjokutaj – Ju falënderoj për pyetjen!

Në fakt, është e vërtetë, ka një rritje të numrit të raportimeve të noterëve, që vjen për shkak të kombinimit kryesisht të dy elementeve, trajnimit të vazhdueshëm, që kemi kryer me këtë kategori, dhe inspektimeve të kësaj kategorie, duke i bërë ata gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për detyrimet që kanë në zbatim të ligjit. Ne si drejtori nuk kemi synim sasisë e informacioneve ose raporteve të dërguara, por jemi të fokusuar te cilësia.

Patjetër që ndërmjet subjekteve që raportojnë jo të gjitha kanë atë nivel njohurish për të bërë një raport cilësor, por ne, rast pas rasti, duke marrë dhe duke analizuar çdo raport, në bazë të gjetjeve të atij raporti, kur ka nevojë për plotësime i rikthehemi subjektit që të bëjë analizën dhe ta plotësojë me elementë shtesë në mënyrë që edhe vetë subjekti të ndërgjegjësohet dhe në raportimin e ardhshëm do të ketë një raport më cilësor.

Në tërësi, cilësinë e raportimit nga noterët do ta vlerësoja të kënaqshme, duke pasur parasysh edhe historikun e mëparshëm dhe kulturën që ekziston në shoqërinë tonë në lidhje me këtë fenomen.

Për sa i përket rënies së numrit të raportimeve nga banka, edhe këtu vlen i njëjti parim, pra jemi të fokusuar te çështja e cilësisë. Bankat janë subjekte raportuese që kanë mënyrën më të mirë të raportimit dhe bëjnë një analizë shuam të detajuar, në tërësi po flas.

Rënia e numrit vjen edhe për shkak të proceseve konsolidues që kanë ndodhur në sektorin bankar vitet e fundit për shkak të përthithjeve apo bashkimit të bankave të ndryshme, duke qenë se nuk kemi më të njëjtin numër bankash, kemi më pak, kështu duke u bashkuar dhe kryqëzuar informacione, një rast bëhet edhe më i qartë, pra humbet edhe dyshimi apo rritet akoma më tepër dyshimi në varësi të të dhënave që mblidhen.

Në tërësi do ta vlerësoja cilësinë e raportimeve nga bankat, shoqëritë e transfertave dhe nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si shumë efektive dhe me një cilësi shumë të mirë.

Me cilësi të mirë do të vlerësoja raportimet e noterëve, ndërkohë që në gjykimin tonë ka vend për përmirësim të ndjeshëm si në cilësi, po ashtu edhe në sasi, për raportimet e zyrave të këmbimit valutor.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gjokutaj!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Më lejoni ta mbyll me dy pyetje!

Ka qenë gjerësisht e njohur në fakt që paratë me prejardhje nga aktiviteti kriminal janë përdorur kryesisht në ndërtim, por para të tilla po përdoren gjithnjë e më shumë edhe për blerjen e medieve dhe portaleve të ndryshme.

A keni pasur raste të tilla të raportimit të aktiviteteve të kësaj natyre?

A e mundëson kuadri i sotëm ligjor identifikimin e rasteve të kësaj natyre?

Pyetja ime e dytë ka të bëjë me një hetim zyrtar të nisur tanimë nga prokuroria e Tiranës, që lidhet me një investigim të bërë nga rrjeti i gazetarëve të lirë lidhur me pagesën nga ana e PD-së të një shume prej 825 mijë dollarësh për lobimin pranë kongresit dhe senatit amerikan. Shoqëria, e cila ka lobuar për PD-në, pak para zgjedhjeve të vitit 2017, por edhe disa ditë më pas, është paguar nëpërmjet kontratave të lidhura ndër të tjera edhe me shoqëri guaskë, të cilat janë të regjistruara në të ashtuquajturat “parajsa fiskale”. Unë nuk jam duke ju pyetur kemi apo jo të dhëna, sepse siç bërë rasti publik, të dhënat kanë ardhur nga SHBA-ja në rastin kur shoqëria lobuese u detyrua që pranë kongresit ose institucionit që ata kanë për raportimin e kontratave t’i raportonte edhe këto kontrata lobimi.

Natyrisht, nuk t’ju pyes nëse keni të dhëna apo jo për faktin që në çdo rast ato do të ishin konfidenciale dhe nuk dua këto të bëhen konsum për publikun, se na e ndalon ligji, por dua t’ju pyes nëse do t’ju kërkohen nga organet përkatëse, nga prokuroria që është duke hetuar, ju do të kishit mundësi të viheshit në kontakt me shërbimin përkatës inteligjent në SHBA dhe të hidhnit dritë mbi këtë rast që media ka raportuar?

Arlind Gjokutaj – Ju falënderoj për pyetjen!

Siç e përmenda, përveç lojërave të fatit, edhe sektori i ndërtimit vlerësohet një sektor me risk të lartë dhe kjo është jo vetëm këtu në Shqipëri, por kudo në botë. Në qoftë se shohim raportet

e vlerësimit të riskut, sektori i ndërtimit gjithmonë shikohet si një sektor me risk të lartë për pastrimin e parave.

Në bazë të ligjit, firmat e ndërtimit ne i kemi subjekte raportuese, i inspektojmë dhe jo më kot edhe në raportin që përmenda, numri më i lartë i subjekteve për të cilat ka pasur një masë administrative, kanë qenë firmat e ndërtimit. Pra, ka një lidhje kryesisht në mospërbushjen e detyrimeve të tyre për raportimin e rasteve të dyshimta.

Për sa i përket çështjes së portaleve, në fakt, rastet që gjenerohen nga sistemi nuk lidhen me tipologji të caktuara, por thjesht kur ka anomali në transaksion. Patjetër që gjatë raportimeve të ndryshme që kemi pasur mund të ketë raste që lidhen edhe me fonde që lëvizin për llogari të organizatave ose të shoqërive që kontrollojnë kompani mediatike, por, rast pas rasti, në bazë të konkluzioneve janë dërguar informacionet përkatëse në organet e zbatimit të ligjit.

Për sa i përket pyetjes për hetimin që përmendët, një pyetje që e kemi konsumuar edhe në raportimin e vitit të kaluar, unë mund të them, pa hyrë në detaje, se ky duke qenë një proces në investigim nga prokuroria (prokuroria ka bashkëpunuar dhe vijon bashkëpunim), ne kemi kryer verifikimin për një pjesë të kërkesave të prokurorisë dhe ajo ka marrë përgjigjet.

Nuk e di në çfarë faze është në prokurori, por për sa na takon neve çdo kërkesë të bërë nga prokuroria e kemi adresuar dhe kemi grumbulluar informacione.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA